

Në bazë të nenit 188 të Ligjit për marrëdhënie pune (tekst i pastër, Gazeta zyrtare e RM nr. 16 /2010) Kongresi i V-të Sindikatës së pavarur të arsimit,shkencës dhe kulturës, të Republikës së Maqedonisë (SASHK) mbajtur më 17.10.2010; Statut për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të SASHK-ut, miratuar nga Këshilli i SASHK-ut më 26.03.2011; Statut për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të SASHK-ut, miratuar nga Këshilli i SASHK-ut më 07.12.2013; Statut për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të SASHK-ut, miratuar nga Këshilli i SASHK-ut më 28.09.2014; Statut për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të SASHK-ut, miratuar nga Këshilli i SASHK-ut më 15.10.2016; Këshilli i SASHK-ut miratoi këtë

STATUT
i Sindikatës së pavarur të arsimit, shkencës dhe kulturës të
Republikës së Maqedonisë
(Tekst i pastër)

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë e Republikës së Maqedonisë është organizatë e mëvetësishme, demokratike dhe e pavarur e punëtorëve në të cilën në baza vullnetare anëtarësohen me qëllim të përfaqësimit, realizimit, mbrojtjes dhe përparimit të intereseve të tyre ekonomike, sociale, profesionale, arsimore, kulturore dhe të drejtave dhe inetresave tjera individuale dhe kolektive të punëtorëve.

Neni 2

Për të shprehur dhe mbrojtur interesat, Sindikata e pavarur per arsim, shkencë dhe kulturë, niset ekskluzivisht nga vullneti i anëtarëve të saj.

Neni 3

Në udhëheqësitë e Organizatave sindikaliste dhe në organet e Sindikatës së pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë nuk mund të propozohen dhe zgjedhen:

-drejtorët dhe punëtorët udhëheqës të cilet punëdhënësi i ka autorizuar të sjellin vendime që lidhen me marrëdhënien e punës të punëtorëve.

Neni 4

Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë ka të drejtë të antarësohet në asociacione në vend dhe jashtë vëndit.

2. EMRI DHE SELIA

Neni 5

Emri i Sindikatës është: Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë e Republikës së Maqedonisë.

Sindikata e pavarur për arsim, shkencë dhe kulturë ka emër të shkurtër: SASHK (në tekstin e mëtutjeshëm: SASHK).

Selia e SASHK-ut ndodhet në Bulevardin "Kolo Racin" nr. 72 g. - Shkup.

3. PARIMET E SASHK-ut

Neni 6

SASHK-u veprimtarinë e vet e bazon në këto parime:

- në anëtarësimin vullnetar;
- mënyra demokratike e të shprehurit dhe marrjes së vendimeve;
- solidariteti dhe reciprociteti;
- të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve dhe organeve të SASHK-ut;
- transparenca gjatë informimit.

4. QËLLIMET DHE METODAT

Neni 7

Qëllimet e SASHK janë:

- ngritja e statusit socio-ekonomik të anëtarësisë;
- mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënie pune;
- dialogu social, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- negociatat dhe lidhja e kontratave kolektive në nivel të degës dhe të punëdhënësit;
- pjesëmarrja në krijimin e politikave arsimore, shkencore dhe kulturore në procesin e miratimit të ligjeve;
- përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës;
- të drejta më të mëdha për sigurimin social, shëndetësor, si dhe sigurimi pensionalo-invalidor;
- të drejta më të mëdha për pushime ditore, javore dhe vjetore;

- preventive më efikase për mbrojtje shëndetësore;
- realizimi i bashkpunimit sindikalist ndërkombëtar;

Neni 8

SASHK-u qëllimet i realizon nëpërmjet të:

- prezentimit dhe përfaqësimit të anëtarësisë;
- platformave, programeve, qëndrimeve, kërkesave etj. për çështjet sociale-ekonomike, për çështje të drejtave juridike të punëtorëve si dhe çështjet profesionale dhe realizimin e tyre;
- negocimi dhe lidhjes së kontratave kolektive dhe pjesmarrjes nëpër këshillat sociale- ekonomike;
- propozimeve më të leverdishme për ndryshimet dhe plotesimet e akteve ligjore dhe të tjera dhe propozimeve për zgjidhje të reja ligjore dhe të tjera;
- formave të ndryshme të presionit sindikalist: letrave dhe deklaratave protestuese, grupimeve publike dhe mitingjeve, shëtitjeve protestuese, demonstratave dhe grevave;
- informimit të opinionit nëpërmjet lajmërimeve, konferencave për shtyp, prezentimeve të drejtperdrejta nëpërmjet të medimeve publike, vendosja e pllakatave në vende publike, web faqe të internetit etj.;
- publikimi i buletineve, doracakëve dhe materialeve tjera të shtypura;
- informimit dhe kërkimit të përkrahjes prej organizatave ndërkombëtare;

5. ANËTARËSIA E SASHK-ut

Neni 9

Anëtarë të SASHK-ut mund të jene të punësuarit në veprimtaritë: kujdesi dhe edukimi i fëmijëve, arsimin fillor, arsimin e mesëm, arsimin e lartë, shkencë, kulturë, sport, pensionistët e kësaj veprimtarie të cilët kanë qenë anëtarë të SASHK-ut para pensionimit të tyre, studentët e të gjitha universitetet në Republikën e Maqedonisë dhe të punësuarit në shërbimin profesional në Këshillin e SASHK-ut.

Neni 10

Anëtarësimi në SASHK është vullnetar pa dallim të bindjeve politike dhe religjioze dhe përkatësisë nacionale, etnike, rasore dhe gjinore.

Neni 11

Të punësuarit në veprimtaritë prej nenit 9 në bazë të vullnetit të shprehur në mënyrë të lirë bëhen anëtarë të SASHK-t me nënshkrimin e fletëregjistrimit me të cilën dëshmohet pranimi i Statutit dhe Programit të SASHK-ut.

I punësuari, i cili nënshkruan fletëregjistrim i jepet librezë anëtarësimi me të cilën e dëshmon anëtarësimin në SASHK.

Libreza e anëtarësimit është pronë e SASHK-ut.

Neni 12

Anëtarësimi në SASHK ndërpritet:

-me çregjistrimin vullnetar të anëtarit nëpërmjet të deklarimit me shkrim deri te kryetari i organizatës sindikale me ç'rast kthen librezën e SASHK-ut.

-me automatizëm;

-me largim nga SASHK-u;

Pa kthimin e librezës së anëtarësisë së SASHK-ut, çregjistrimi është i pavlerë.

Largimi kolektiv nga SASHK-u është i pavlefshëm

Neni 13

Anëtari nuk mundet në mënyrë vullnetare të çantarlohet nga SASHK-u nëse ka shfrytëzuar mjete financiare e bazë të solidaritetit nga mjetet e SASHK-ut, pa dallim se a behet fjale për mjete nga organizata sindikale, Këshilli rajonal, mjete nga Këshilli i SASHK-ut, Fondi sindikal ose fonde tjera të SASHK-ut.

Largimi vullnetarë nuk vlen edhe në rastet kur anëtari ka shfrytëzuar të drejtën që është e siguruar me marrëveshje kolektive, e nënshkruar nga ana e SASHK-ut apo me dokumente tjera (Marrëveshje etj.) me partnerët përkatës social në të gjitha nivelet, me shfrytëzimin e disa nga këto të drejta anëtari ka përfituar rritje të mjeteve financiare, apo përmirësimin e statusit në vendin e punës, si dhe lirim nga gjërat që rezultojnë nga autoritetet shtetërore (inspektionet, organet drejtuese të institucionit, gjykatat etj.), si merito për veprimet dhe aktivitetet e organeve të SASHK-ut.

Neni 14

Anëtari i SASHK-ut, i cili dëshiron të tërhiqet vullnetarisht nga SASHK-u, duke u bazuar në rregullat të theksuara në nenin 13 të këtij Statuti, në këtë rast largimi mund të bëhet pas 3 viteve nga dorëzimi i kërkesës për largimin nga SASHK-u.

Neni 15

Anëtari largohet nga evidenca e organizatës sindikale automatikisht, nëse i ndërpritet mardhënia e punës në intitucion në cfardo baze.

Neni 16

Largimin e kryen organizata sindikale në të cilën vepron anëtari. Kjo masë zbatohet në rast të mosrepektimit të Statutit të SASHK-ut dhe vendimeve të organeve të SASHK-ut, derisa me parë të marrë mendim nga këshilli regjional, në të cilën është e organizuar organizata sindikale.

Vendimi për largimin e anëtarit dërgohet në afat prej 15 ditësh prej aprovimit të tij.

Anëtari ndaj të cilit është shqiptuar masa për largim, ka të drejte ankese deri te Kuvendi i SASHK-ut. Nëse anëtari i larguar parashtron ankesën deri te Këshilli i SASHK-ut anëtarësimi i tij pushon. Nëse Kuvendi i SASHK-ut e refuzon ankesën, atëherë largimi është në fuqi.

Neni 17

Anëtari të cilit i ka përfunduar anëtarësimi, në qoftë se shpreh dëshirë për anëtarësim të sërishëm në SASHK, duhet me shkrim të drejtohet deri te organizata sindikale. Organizata sindikale, në mbledhjen që pason mund të vendos ta pranoj për anëtarë në bazë të largimit vullnetarë nga SASHK-u dhe ta evidentoj, duke i dhënë librezë të re anëtarësimi.

Sipas rregullit, anetari që është larguar vullnetarisht nga SASHK-u, pa patur arsye objektive për këtë veprim, nuk duhet anëtarësuar në SASHK përsëri.

6.TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARIT TË SASHK-ut

Neni 18

Anëtari i SASHK-ut i ka këto të drejta:

- të gëzojë mbrojtje nga SASHK-u për realizimin e të drejtës për punë;
- të shfrytëzojë të drejtat prej marrëveshjeve kolektive;
- të shfrytëzojë të drejta prej Fondit sindikal dhe fondeve tjera të SASHK-ut;
- të shfrytëzojë ndihmë pa pagesë dhe mbrojtje juridike;
- të propozojë, të zgjedh dhe të zgjidhet në organet e SASHK-ut;
- të merr pjesë në marrjen e vendimeve dhe në realizimin e tyre në organizatat sindikale;

-mendimin e vet ta shpreh lirshëm dhe ta mbrojë nëpër, konferenca, këshillime dhe kongrese;

-të pranojë informata për aktivitetet sindikale të organeve të SASHK-ut;

-të paraqesë deri te organet sindikale kërkesa, mendime, propozime, vërejtje kritike dhe ankesa lidhur me probleme më të mëdha sindikale dhe të kërkojë përgjegje për zgjedhjen e tyre aktive.

-të merr pjesë në punën e organizatës sindikale;

-edukim sindikal;

-të pranojë shpërblime dhe mirënjohje nga SASHK-u për aktivitetet sindikale;

-furnizim më të favorshëm me nevoja elementare jetësore nëpërmjet organizatës sindikale;

-të realizojë edhe të drejta tjera të cilat i siguron SASHK-u.

Neni 19

Anëtari i SASHK-ut i ka këto obligime:

-të respektojë dhe zbatojë Statutin dhe Programin e SASHK-ut;

-të respektojë dhe zbatojë vendimet e Kongresit dhe të organeve të SASHK-ut;

-të sendërtojë bashkimin e SASHK-ut dhe ta ruaj autoritetin e tij;

-të mos ndikohen aktivitetet e SASHK-ut nga qëndrimet politike, përkatësitë nacionale, etnike apo racore si dhe nga përkatësia fetare;

-të paguaj rregullisht anëtarësinë sindikale;

-në rast kalimi në organizatë tjetër sindikale të SASHK-ut në afat prej 30 ditë të lidhet me organizatën tjetër.

7. ORGANIZATA SINDIKALIE E SASHK-ut

Neni 20

Organizata sindikale e SASHK-ut (në tekstin e mëposhtëm: Organizata sindikale) është formë elementare e organizimit në SASHK.

Organizata sindikale ka cilësinë e personit juridik dhe posedon xhiro-llogari

Neni 21

Me iniciativë të punësuarve formohet organizata sindikale. Iniciativë për formimin e organizatës sindikale mund të jep grup i punëtorëve të institucionit.

Thirrjen e Kuvendit Themelues të Organizatës Sindikale e bën Këshilli i iniciativ i përbërë prej më së paku tre të punësuarve.

Vendim për formimin e Organizatës sindikale sjell Kuvendi Themelues i Organizatës sindikale dhe për këtë duhet informuar Këshillin e SASHK-ut.

Per formimin e Organizatës sindikale duhen së paku tre anëtare.

Neni 22

Organizata sindikale formohet sipas parimit: një institucion, një organizatë sindikale e SASHK-ut.

Neni 23

Organizata sindikale realizon funksione dhe detyra të cilat dalin prej Statutit dhe Programit të SASHK-ut, veçanërisht:

- merr pjesë në bidesime të procedurave për miratimin e marrëveshjeve kolektive dhe angazhohet në zbatimin e tyre;

- merr pjesë në debatet gjatë procedurës për sjelljen e akteve në institucion me të cilat rregullohet pozita ekonomike dhe sociale e anëtarësisë;

- sipas nevojës lidh marrëveshje kolektive në nivel të punëdhënësit;

- proponon kandidat të mundëshëm në organet e SASHK-ut;

- sjell vendime për grevë në organizatën sindikale dhe forma të tjera të shprehjes së revoltës, për çështje të cilat janë në kompetencë të organeve të institucionit të punëdhënësit, në te cilën vepron organizata sindikale.

Neni 24

Organizata sindikale mund të punojë nëse janë të pranishëm më tepër se gjysma e anëtarëve ndërsa vendime sillen me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Neni 25

Organet e Organizatës sindikale janë: Kuvendi, Këshilli mbikqyres dhe Kryetari.

Neni 26

Kuvendin e përbëjnë të gjithë anëtarët e Organizatës sindikale dhe ai mbahet një herë në pesë vite ose sipas nevojës.

Kuvendi mund të mbahet nëse në të janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të organizatës sindikale ndërsa vendimet sillen me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Kuvendi e vlerëson punën e kryetarit dhe e aprovon Raportin e Këshillit Mbikqyrës.

Kuvendi zgjedh kryetarin dhe sekretarin e organizatës sindikale dhe Këshillit Mbikqyrës. Kryetari zgjedhet pas mendimit paraprak nga

Këshilli regjional i SASHK-ut në të cilën është anëtare organizata sindikale.

Pas zgjedhjes apo rizgjedhjes së kryetarit të organizatës sindikale, i njejti nënshkruan betimin solemn. Teksti i betimit, i cili miratohet nga Këshilli i SASHK-ut, lexohet nga kryetari i kryesisë së Kuvendit, kryetari i sapozgjedhur (rizgjedhuri) e përsërit me zë tekstin para anëtarëve të Kuvendit dhe më pas e nënshkruar publikisht Betimin solemn.

Dokumenti, i cili nënshkruhet në dy kopje mbahen në arkivat e organizatës sindikale, ndërsa kopja e dytë së bashku me dokumentacionin tjetër dorëzohet në Këshillin e SASHK-ut.

Kuvendi mund të diskutoj dhe vendos për shkarkimin e kryetarit të organizatës sindikale dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, nëse të njejtit e kanë shkelur Statutin e SASHK-ut dhe vendimet e Këshillit të SASHK-ut. Pas vendimit për shkarkimin e tyre, të njejtët kanë të drejtë të ankohen tek Këshilli i SASHK-ut, ku dy e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit vendos mbi ankesën, ndërsa vendimi i Këshillit është përfundimtarë.

Mandati i kryetarit dhe sekretarit zgjat pesë vite me mundësi që të rizgjidhen.

Neni 27

Kryetari i Organizatës sindikale i thirr mbledhjet dhe kryeson me to.

Mbledhja e Organizatës sindikale thirret edhe pas deponimit të nënshkrimeve deri te kryetari i Organizatës sindikale nga më së paku një e treta e anëtarëve të Organizatës sindikale me kërkesë me shkrim për organizimin e mbledhjes me propozim të rendit të ditës. Kryetari thirr mbledhje në afat prej 30 ditëve.

Neni 28

Kryetari i organizatës sindikale i ka këto detyra:

- përcjell gjendjen ekonomike dhe sociale të anëtarëve të organizatës sindikale, ndermerr iniciativa dhe kërkesa dhe propozon zgjidhje për përmirësimin e kësaj gjendje tek punëdhënësi;

- negocion dhe pas autorizit të organizatës sindikale nënshkruan Marrëveshje kolektive me punëdhënësin dhe e përcjell zbatimin e saj;

- i mbron të drejtat për marrëdhënie pune dhe i përfaqëson anëtarët gjatë realizimit të kësaj në institucion;

- angazhohet për krijimin dhe përmirësimin e kushteve për punë dhe mbrojtjes gjatë punës;

- angazhohet për sigurimin e kushteve për realizimin e nevojave për aktivitete kulturore, rekreacion, pushim dhe aktivitete sportive të anëtarëve;

-është i obliguar që me kohë dhe në mënyrë të drejtë të informojë anëtarët dhe organet e SASHK-ut.

-i përcjell qëndrimet e Organizatës sindikale deri te Këshilli regjional i SASHK-ut;

-kujdeset për llogaritjen e sakte dhe në kohe të pageses sindikale të anëtarësisë, për çdo anëtarë të organizatës sindikale gjatë përgatitjes së pagës, në bazë të Vendimit të Këshillit të SASHK-ut për ndarjen e anëtarësisë;

-ndërrmer aktivitete për anëtarësimin e anëtarëve të ri në Sindikat;
Kryetari është nënshkrues i të gjitha dokumenteve të Organizatës sindikale dhe personi që urdhëron mënyrën e përdorimit të mjeteve.

Kryetari e ruan dokumentacionin, vulën dhe faksimilin e Organizatës sindikale dhe përfaqëson Organizatën sindikale në aspektin juridik edhe ndaj personave të tretë.

Neni 29

Në mungesë të kryetarit kompetencat e tij i kryen sekretari.

Pas përfundimit të mandatit të kryetarit, për çfarëdo arsye, në atë rast dokumentacioni, vula dhe faksimili t'i dorëzohen kryetarit të sapozgjedhur apo nëse nuk janë bërë zgjedhje të sekretarit të organizatës sindikale.

Neni 30

Kuvendi i Organizatës sindikaliste e zgjedh këshillin mbikqyrës prej tre anëtarëve dhe tre zëvendësve. Këshilli mbikqyrës nga përbërja e tij zgjedh kryetarin. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës zgjat pesë vite pa të drejtë të rizgjedhjes së mandatit.

Këshilli Mbikqyrës mbikqyr punën materiale financiare të Organizatës sindikaliste më së paku dy herë në vit.

Në rast të konstatimit të parregullsive të punës materiale financiare, Këshilli Mbikqyrës e informon kryetarin e organizatës sindikale, Këshillin Mbikqyrës regjional dhe Këshillin Mbikqyrës të SASHK-ut.

8. KËSHILLAT REGJIONALE

Neni 31

Në nivel të regjioneve formohen Këshilla regjionale të SASHK-ut.

Këshillat regjionale janë persona juridik dhe kanë vulë, faksimil dhe xhiro llogari.

Kontabiliteti i xhiro llogarive bankiare kryhet nga ana e shërbimit profesional të SASHK-ut.

Këshillat regjionale të SASHK-ut finansohen një pjesë prej taksës së anëtarimit në SASHK të cilat organizatat sindikale i ndajnë në pajtim me Vendimin e Këshillit të SASHK-ut.

Neni 32

Anëtarë të Këshillave regjionale janë të gjithë kryetarët e organizatave sindikaliste të SASHK-ut të regjionit të caktuar.

Këshillat regjional:

- negociojnë me organet e vetqeverisjes lokale për çështjet sociale-ekonomike të cilat janë në kompetenca të vetqeverisjes lokale;

- lidhin marrëveshje kolektive për veprimtarinë dhe ente të cilat financohen me mjetet e vetqeverisjes lokale;

- sjellin vendime për organizimin e formave të ndryshme të presionit: letra protestuese, tubime publike dhe mitingje, shtetitje protestuese, demonstrata dhe greva, për çështje të cilat janë në kompetenca të vetqeverisjes lokale;

- shprehin mendimet dhe propozime për Buxhetin e vetqeverisjes lokale në raport me finansimin e veprimtarive.

Neni 33

Këshilli regjional, në pajtim me kryetarin e SASHK-ut, zgjedh kryetarin dhe sekretarin e Këshillit regjional me mandat prej 5 viteve dhe mundësi për rizgjedhje.

Pas zgjedhjes apo rizgjedhjes së kryetarit të këshillit regjional, i njejtë nënshkruan betimin solemn. Teksti i betimit, i cili miratohet nga Këshilli i SASHK-ut, lexohet nga kryetari i kryesisë së Kuvendit të këshillit regjional, kryetari i sapozgjedhur (rizgjedhur) e përsërit me zë tekstin para anëtarëve të kuvendit dhe më pas e nënshkruar publikisht Betimin solemn.

Dokumenti, i cili nënshkruhet në dy kopje mbahen në arkivat e këshillit regjional, ndërsa kopja e dytë së bashku me dokumentacionin tjetër dorëzohet në Këshillin e SASHK-ut.

Kryetari i Këshillit regjional, pas konsultimit me kryetarin e SASHK-ut, organizon mbledhjet e Këshillit dhe i udhëheq ato.

Kryetari i Këshillit regjional është i obliguar që me kohë dhe drejtë të informojë Këshillin për qëndrimet, vendimet, përfundimet dhe dokumentet tjera të Këshillit të SASHK-ut.

Kryetari i këshillit regjional të SASHK-ut e paraqet dhe përfaqëson regjionin në aspektin financia edhe ndaj personave të tretë.

Neni 34

Kryetari i Këshillit regjional është i obliguar që me kohë të informoj kryetarin e SASHK-ut për të gjitha aktivitetet më të rëndësishme të

këshillit regjional të SASHK-ut dhe posacërisht nëse kryetari i SASHK-ut kërkon informatë të shkruar apo gojore (në telefon) në çështje të caktuara.

Neni 35

Kryetari i Këshillit regjional informon publikun për aktivitetet më të rëndësishme të këshillit, përmes lajmërimeve, pres konferencave dhe paraqitjeve direkte në mediumet për informim.

Neni 36

Kryetari i Këshillit është i obliguar ti përcjellë aktivitetet në çdo organizatë sindikale, për të inkurajuar dhe ndihmuar aktivitetet e tyre, në marrëveshje me kryetarin e organizatës sindikale. Nëse në ndonjërin nga organizatat sindikale nga regjioni konstatohet se është bërë shkelje e dispozitave të Statutit të SASHK-ut dhe moszbatimi i vendimeve të organeve të SASHK-ut, kryetari i këshillit regjional është i obliguar që menjëherë të informoj kryetarin e SASHK-ut, në rast të shkeljeve më të rënda të Statutit të SASHK-ut nga anëtarë individual të organizatës sindikale ka te drejtë të kërkoj sanksionimin e tyre para Këshillit të SASHK-ut.

Në rast se në ndonjërin nga institucionet, ku veprojnë organizatat sindikale nga regjioni konkret krijohen probleme që i tejkalojnë mundësitë që organizata sindikale ti zgjidh, kryetari i këshillit regjional detyrimisht merr masa përmes organeve të vetëqeverisjes lokale ose në marrëveshje me kryetarin e SASHK-ut, përmes autoriteteve kompetente të shtetit për tejkalimin e problemit të krijuar.

Kryetari i këshillit regjional është i obliguar që të organizojë mbledhje të këshillit regjional më së paku njëherë në tre muaj, e obligueshme për çështje të cilat janë kompetente të këshillit regjional.

Kryetari i Këshillit regjional cakton mbledhje të organizates sindikale, nëse kryetari i organizatës sindikale nuk ka caktuar mbledhje edhe pse për këtë kanë qenë të plotësuar kushtet të përcaktuara me nenin 27, alinea 2.

Kryetari i këshillit regjional të SASHK-ut përfaqëson Regjionin në sistemin e pagesave para personave të tretë.

Kryetari i këshillit regjional ruan dokumentacionin, vulën dhe faksimilin e këshillit regjional dhe është nënshkruar i të gjitha dokumenteve dhe përgjegjës për mënyrën e përdorimit të mjeteve.

Neni 37

Kryetari dhe sekretari i këshillit regjional të SASHK-ut shkarkohet para skadimit të mandatit nëse i shkel Statutin e SASHK-ut dhe vendimet e Kuvendit të SASHK-ut, si dhe për shkak të jo aktivitetit në

kryerjen e funksionit të tij. Inicativë për shkarkim të kryetarit apo sekretarit mund të parashtrojë organizata sindikale e SASHK-ut në regjion, që përfaqësojnë më së paku një të tretën e numrit të përgjithshëm të organizatave sindikale në Regjion. Vendimi për shkarkimin e kryetarit apo sekretarit e këshillit regjional, në marrëveshje paraprake me kryetarin e SASHK-ut, sjell këshilli regjional, më së paku me dy të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit regjional.

Derisa këshilli regjional i SASHK-ut miraton Vendimin për shkarkimin e kryetarit apo sekretarit të këshillit regjional, pa pëlqimin e kryetarit të SASHK-ut, e njejta nuk vlen.

Neni 38

Këshilli regjional zgjedh Këshillin mbikëqyrës nga 3 anëtarë dhe 3 anëtarë zëvendës.

Këshilli mbikëqyrës nga alinea 1 bën mbikëqyrjen e punës materiale-finansiare të Këshillit regjional sëpaku në herë në vit të njejtën e dorëzon tek këshilli.

Raportin nga alinea 2, Këshilli mbikëqyrës e dërgon deri te Këshilli mbikëqyrës i SASHK-ut dhe Këshilli i SASHK-ut.

Në rast të paregullësive materialo-financiare të punës, Këshilli mbikëqyrës e raporton Këshillin mbikëqyrës të SASHK-ut

9. ORGANET E SASHK-ut

Neni 39

Organet e SASHK-ut janë: Kongresi, Këshilli, Kryetari dhe Këshilli mbikëqyrës.

9.1. KONGRESI

Neni 40

Kongresi është organi më i lartë i SASHK-ut i cili thirret çdo pesë vjet. Vendimin për datën dhe vendin e mbajtjes si dhe propozimin e rendit të ditës për punën e Kongresit e sjell Këshilli , më së voni 60 ditë para mbajtjes së tij.

Propozim dokumentet për Kongres lëshohen në debat para antarsisë më së paku 30 ditë para mbajtjes së Kongresit.

Neni 41

Numri, përbërja dhe struktura e delegatëve të Kongresit përcaktohet me Vendim të posaçëm të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit janë delegat të Kongresit.

Neni 42

Që të punojë Kongresi duhet të jenë të pranishëm dy të tretat e delegatëve të Kongresit ndërsa vendimet janë të plotëfuqishme nëse për ato deklarohet shumica e delegatëve të pranishëm në Kongres.

Neni 43

Kongresi i ka këto kompetenca:

- sjell Rregulloren e punës së Kongresit
- sjell Statutin dhe dokumente programore;
- e shqyrton dhe aprovon Raportin e Këshillit për aktivitetet e SASHK-ut dhe Raportin e Këshillit mbikqyrës;
- bën zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës;
- zgjedh kryetarin e SASHK-ut

Neni 44

Në periudhës mes dy Kongreseve mund të organizohet Konferencë e SASHK-ut në të cilën bëhet vlerësimi i rezultateve të deriatëhershme për realizimin e Programit dhe caktohen aktivitetet e mëtutjeshme.

Neni 45

Numri i pjesëmarrësve si dhe struktura e tyre përcaktohet me vendim për thirrjen e Konferencës të cilën e sjell Këshilli i SASHK-ut.

Neni 46

Kongresi i jashtëzakonshëm i SASHK-ut mund të thirret me vendim të Këshillit të SASHK-ut, me kërkesë nga dy të treta e organizatave sindikatale të SASH-ut.

Vendimi për thirrje në Kongresin e jashtëzakonshëm, Këshilli e vendos me së paku dy të tretat e anëtarëve të Këshillit.

Për Kongresin e jashtëzakonshëm të njëjtë janë delegatët nga Kongresi i rregullt.

Me vendimin për mbajtjen e Kongresit të jashtëzakonshëm, Këshilli duhet të përcaktojë pikën definitive të rendit të ditës, në bazë të cilës do të diskutojë dhe vendos Kongresi i jashtëzakonshëm.

Për të punuar Kongresi i jashtëzakonshëm duhet të jenë të pranishëm dy e treta e delegatëve të Kongresit të rregullt, vendimet janë të plotëfuqishme nëse janë shumica e të pranishëm në Kongresin e Jashtëzakonshëm.

9.2.KËSHILLI

Neni 47

Këshilli është organi më i lartë i SASHK-ut, i cili punon dhe vepron në mes të dy kongreseve.

Neni 48

Këshilli i SASHK-ut ka cilësin e personit juridik dhe ka xhiro-llogari.

Neni 49

Struktura e Këshillit është adekuate me strukturën e anëtarëve të SASHK-ut sipas veprimtarive.

Vendimin për numrin, përbërjen, kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit e sjell Këshilli i SASHK-ut.

Neni 50

Kryetarët dhe sekretarët e Këshillave regjionale, kryetari i SASHK-ut, nënkryetarët e Këshillit dhe sekretari gjeneral i Këshillit sipas funksionit janë anëtarë të Këshillit të SASHK-ut.

Neni 51

Nëse anëtari i Këshillit të SASHK-ut tre herë një pas një pa arsye nuk merr pjesë në mbledhjet e Këshillit, atëherë i ndërpritet funksioni i tij si anëtarë i Këshillit dhe vendi i kryetarit regjional nga vjen, behet zgjedhje e re në pajtim me kryetarin e SASHK-ut.

Neni 52

Këshilli i realizon funksionet e SASHK-ut të përcaktuara me këtë Statut dhe vepron në bazë të përcatimeve programore.

Këshilli për punën e vet përgjigjet para Kongresit të SASHK-ut.

Neni 53

Këshilli punon dhe vendos, sipas ndërlikueshmërisë së çështjeve që duhet të jenë në rendin e ditës, në përbërje më të gjërë ose përbërje më të ngushtë të Këshillit.

Në përbërje më të gjërë Këshilli është në përputhje me nenin 50 të këtij Statuti.

Në përbërje më të ngushtë Këshillin e përbëjnë: kryetarët e këshillave rajonal, kryetari i SASHK-ut dhe sekretari gjeneral i Këshillit të SASHK-ut.

Neni 54

Këshilli i SASHK-ut në përbërje më të gjere, ka këto kompetenca:

- i realizon përcaktimet e Kongresit të SASHK-ut;
- sjell programe operative dhe aprovon raporte të punës;
- i përcakton interesat e përbashkëta dhe aktivitetet për realizimin e tyre;
- sjell Vendim për autorizimin e kryetarit të SASHK-ut për nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive;
- ofron propozime dhe mendime gjatë përcaktimit të normativave dhe standardeve për punë të punësuarve nëpër veprimtari dhe kriteret për realizimin e titujve në bazë të ligjit;
- inicon organizimin e grevës gjenerale para organizatave sindikaliste dhe në bazë të deklarimeve të organizatave sindikaliste sjell vendime;
- sjell Planin financiar dhe miraton raportin financiar për punë të xhiro llogarisë së Këshillit të SASHK-ut.
- sjell vendim për shpalljen e zgjedhjeve të rregullta në SASHK;
- i përcakton qëllimet dhe akitivitetet e përbashkëta me Sindikatat tjera të organizatave sindikale dhe asociacioneve tjera nga vendi dhe nga jashtë;
- sjell akte me të cilat rregullohet puna e organeve dhe trupave të SASHK-ut;
- formon fonde të SASHK-ut;
- kryen edhe punë tjera në pajtim me Statutin;

Neni 55

Këshilli i SASHK-ut në përbërje më të ngushtë, ka kompetencat e mëposhtme:

- i vërteton bazat e përbashkëta për negociim dhe lidhje të marrëveshjeve kolektive;
- Me propozime dhe mendime merr pjesë në procedurën për miratimin e ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë funksionimin juridik, socialo-ekonomike dhe interesat profesionale, si dhe qëndrime në lidhje me realizimin e tyre;
- Sjell vendime për shkarkimin e kryetarëve të organizatave sindikale dhe përjashtime nga anëtarësia e SASHK-ut, për shkelje të Statutit të SASHK-ut dhe moszbatimin e vendimeve të Këshillit të SASHK-ut, me propozim të këshillit regjional të SASHK-ut. Nëse Këshilli regjional për çfardo arsye nuk vepron në pajtim me këtë cështje, në atë rast Vendimi për shkarkimin dhe përjashtimin direkt e sjell Këshilli i SASHK-ut;
- përcakton qëllime të përbashkëta dhe aktivitete me sindikatat tjera dhe asociacione në vend dhe jasht vendit;

- bën zgjedhjen e delegatëve dhe anëtarëve në organet e asociacioneve tjera;
- propozon kandidat të mundëshëm për kryetarë të asociacioneve tjera;
- organizon takime të ndryshme të SASHK-ut;
- sjell aktet për punën e Shërbimit profesional të SASHK-ut dhe Këshillit të SASHK-ut;

Neni 56

Këshilli i SASHKj-ut në përbërje më të gjërë apo më të ngushtë që të mund të punojë, në mbledhje duhet të marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij, ndërsa vendimet janë të plotëfuqishme nëse për ato deklarohen dy të tretat e anëtarëve të përgjithshëm.

9.3.KRYETARI I SASHK-ut

Neni 57

Kongresi, me propozim të Këshillit të përgjithshëm, e zgjedh kryetarin e SASHK-ut.

Pas zgjedhjes apo rizgjedhjes së kryetarit të SASHK-ut, i njëjti nënshkruan Deklaratën solemne. Teksti i deklaratës solemne, i cili miratohet nga Këshilli i SASHK-ut, lexohet nga kryetari i kryesisë së Kongresit, kryetari i sapozgjedhur (rizgjedhur) e përsërit me zë tekstin para delegatëve dhe më pas e nënshkruar publikisht Deklaratën solemne.

Dokumenti, i cili nënshkruhet së bashku me dokumentacionin ruhet në arhivat e Këshillit të SASHK-ut.

Neni 58

Mandati i kryetarit të SASHK-ut zgjat pesë vjet dhe i njëjti mund të përsëritet.

Në rast kur kryetari i SASHK-ut është i penguar përgjithmonë të kryejë funksionin ose jep dorëheqje, Këshilli e zgjedh njërin prej nënkryetarëve për ushtrues të detyrës kryetar.

Neni 59

Kryetari i SASHK-ut e prezenton dhe përfaqëson Këshillin e SASHK-ut në aspekte juridike dhe para personave të tretë.

Neni 60

Kryetari i ka këto detyra:

- thirr mbledhjet e Këshillit dhe udhëheq me to;
 - realizon bisedime dhe negociata me partnerët adekuat të shtetit dhe i nënshkruan marrëveshjet kolektive sipas veprimtarive para vendimit për autorizimin nga ana e Këshillit në përbërje më të gjërë, për nënshkrimin konkret të Marrëveshjeve kolektive;
 - i përfaqëson qellimet dhe interesat e SASHK-ut;
 - i orienton aktivitetet e Këshillit në pajtim me Statutin dhe Programin e SASHK-ut;
 - kontakton mjetet e informimit publik dhe mban konferenca për shtyp;
 - realizon bashkepunim me sindikata tjera, shoqata dhe organizata joqeveritare;
 - realizon kontakte dhe bashkepunim me sindikatat dhe asociacione adekuate nga shtetet tjera;
 - i nënshkruan të gjitha aktet e Këshillit të SASHK-ut;
 - i nënshkruan aktet e vecanta me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në Shërbimin profesional të Këshillit të SASHK-ut;
 - urdhëron mënyrën e përdorimit të mjeteve të Këshillit të SASHK-ut dhe të Fondit sindikal;
 - në çdo mbledhje të Këshillit në përbërje më të gjërë, paraqet raport mbi veprimtaritë e rëndësishme të SASHK-ut mes dy mbledhjeve të Këshillit;
 - kryen edhe punë tjera në pajtim me këtë Statut;
- Kryetari për punën e tij përgjigjet para Kongresit të SASHK-ut;

Neni 61

Kryetari i SASHK-ut, nëse për herë të dytë nuk zgjidhet ose para kohe shkarkohet, kthehet në institucionin ose ndërmarrjen prej nga ka ardhë në funksion, në vendin adekuat të punës.

Neni 62

Me propozimin e kryetarit të SASHK-ut, Këshilli në përbërje më të gjërë zgjedh sekretarin gjeneral të Këshillit të SASHK-ut.

Mandati i sekretarit gjeneral zgjat pesë vite dhe mund të përsëritet.

Neni 63

Sekretari gjeneral i Këshillit të SASHK-ut i ka këto obligime:

- i përgadit materialet për mbledhjet e Këshillit të SASHK-ut (në dy përbërje);

- i koordinon aktivitetet dhe kontakton me Këshillet regional dhe organizatat sindikale;
- i organizon aktivitetet për edukim në SASHK;
- e organizon punën dhe është udhëheqës i Shërbimit profesional të Këshillit të SASHK-ut;
- kryen edhe punë të tjera me autorizim të kryetarit të SASHK-ut në pajtim me Statutin e SASHK-ut.

Neni 64

Sekretari gjeneral i Këshillit të SASHK-ut, nëse nuk zgjidhet sërish ose shkarkohet para kohe, ai kthehet në entin ose ndermarrjen prej nga ka ardhur në funksion, në vendin adekuat të punës.

Neni 65

Me propozim të kryetarit të SASHK-ut, Këshilli emëron dy nënkryetarë të Këshillit të SASHK-ut.

Nënkryetarët funksionin e tyre e kryejnë në mënyrë vullnetare.

Neni 66

Nënkryetarët e Këshillit të SASHK-ut sipas funksionit janë anëtarë të Këshillit të SASHK-ut.

Nënkryetarët e Këshillit të SASHK-ut i kanë këto obligime:

- marrin pjesë në dialogje sociale me organet kompetente në marrëveshje me kryetarin e SASHK-ut;
- inicojnë aktivitete në Këshill;
- në mungesë të kryetarit të SASHK-ut me autorizimin e tij i udhëheqin mbledhjet e SASHK-ut;
- kryejnë edhe punë të tjera në marrëveshje me kryetarin e SASHK-ut por në pajtim me Statutin dhe Programin e SASHK-ut.

9.4. KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 67

Kongresi e zgjedh Këshillin mbikqyrës prej tre anëtarëve dhe tre zëvendësve.

Këshilli mbikqyrës prej përbërjes së tij zgjedh kryetarin.

Anëtarët e Këshillit nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit mbikqyrës.

Mandati i anëtarëve të Këshillit mbikqyrës zgjat pesë vjet, pa mundësi rizgjedhjeje.

Neni 68

Këshilli i mbikqyrës i kryen këto punë:

-mbikqyr punën materiale-financiare të Këshillit të SASHK-ut, të Fondit sindikal të SASHK-ut dhe të Këshillave regjionale të SASHK-ut dhe organizatat sindikale;

-kontrollon shpërndarjen dhe përdorimin e mjeteve financiare;

-së paku një herë në vit kontrollon dhe bën revizion të punës së përgjithshme material-financiare dhe të ekzekutimit të vendimeve, rregulloreve dhe shfrytëzimit të pasurisë.

Këshilli mbikqyrës ka të drejtë të kontrollojë punën financiare të Këshillit të SASHK-ut, të Këshillave regjionale të SASHK-ut dhe të organizatave sindikale pa paralajmërim. Për të gjitha veprimet e kryera kontrolluese Këshilli mbikqyrës formulon proces verbal dhe të njëjtin ia dorzon Këshillit.

Bashkëpunon me shërbimet inspektuese të autorizuara për punë financiare në pajtim me ligjin.

Ky këshill raporton për punën materiale financiare të Këshillit të SASHK-ut

10.FINANSIMI DHE MJETET MATERIALE TË SASHK-ut

Neni 69

Puna e SASHK-ut financohet nga taksa e anëtarimit dhe prej të ardhurave tjera si: donacionet, sponsorimet, kamata e mjeteve të veta, aksioneve, akteve bankare dhe dhuratave.

Lartësia e anëtarisë dhe shpërndarja e saj percaktohet me vendim të Këshillit të SASHK-ut

Neni 70

Antarësia sindikale kryhet gjatë marrjes së pages mujore me llogaritje nëpërmjet të listës pagesore.

Neni 71

Mos zbatimi i vendimeve për shpërndarjen e taksës sindikale për shfrytëzimin e mjeteve, konsiderohet shkelje e Statutit të SASHK-ut.

11.FONDI SINDIKAL I SASHK-ut

Neni 72

Për realizimin e ndihmës materiale solidare dhe shfrytëzimin e leverdive tjera materiale, në kuadër të SASHK-ut, formohet Fondi sindikal i SASHK-ut. (në tekstin më tutje: Fondi).

Neni 73

Anëtare të Fondit janë Organizatat sindikale të cilat në mënyrë vullnetare kanë vendos të anëtarsohen.

Neni 74

Me Fondin udhëheq Kuvendi i Fondit të cilin e përbëjnë nga një anëtarë nga Regjionet, të deleguar nga anëtarët e Fondit.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Fondit zgjat pesë vite, me mundësinë e rizgjedhjes.

Neni 75

Kuvendi i Fondit, me vendim të posaçëm e përcakton lartësinë e taskës së anëtarësimit që duhet paguar në Fond.

Neni 76

Kuvendi i Fondit, nga anëtarët e Kuvendit zgjedh Këshillin drejtues prej pesë anëtarëve.

Kryetar i Kuvendit dhe i Këshillit drejtues sipas funksionit është kryetari i SASHK-ut.

Neni 77

Me mjetet e Fondit menaxhon Këshilli drejtues. Për shfrytëzime të ndara të të drejtave, të cilat përcaktohen me Rregullore të Fondit sindikal të SASHK-ut të cilën e aprovon Kuvendi i Fondit, vendos kryetari i SASHK-ut.

Neni 78

Anëtarët e fondit përmes këshillit regjional të SASHK-ut bëjnë zgjedhjen e Këshillit Mbykqyrës të fondit Sindikal, që përbëhet nga tre anëtarë dhe tre zëvendës anëtarë.

Neni 79

Këshillet regjionale të SASHK-ut, dakordohen mes veti se nga cili regjion do të jenë të zgjedhur anëtarët dhe zëvendësit e tyre në këshillin

mbykqyrës, në bazë të principit të mos jenë të zgjedhur nga dy anëtarë apo zëvendës të njëjtit regjion.

Neni 80

Këshilli mbykqyrës i SASHK-ut në fund të vitit përgatit raport për punën financiare të Fondit të cilën e aprovon Kuvendi.

Neni 81

Mandati i anëtarëve të Këshillit mbykqyrës dhe zëvendësve të tyre zgjat pesë vite pa mundësin e rizgjedhjes së tyre.

Neni 82

Shpenzimet për shfrytëzimin e Fondit bien mbi mjetet nga xhiro-llogaria e Fondit.

12.SHËRBIMI PROFESIONAL

Neni 83

Për kryerjen e punëve profesionale, administrative, financiare teknike dhe të tjera për nevojat e SASHK-ut, në kuadër të Këshillit të SASHK-ut formohet Shërbim profesional.

Numri i ekzekutuesve dhe detyrave të punës rregullohen me akte të posaçme të cilat i sjell Këshilli i SASHK-ut.

13.AMBLEMA, FLAMURI, KËNGA SOLEMNE DHE VULA

Neni 84

SASHK-u ka amblemë e cila simbolizon SASHK-un. Amblema është rreth me bazë të verdhë në të cilin në mënyrë stilistike janë libri dhe pena, shtylla arkeologjike, lira dhe një pjesë e topit sportiv.

Neni 85

SASHK-u e ka flamurin e vet dhe këtë me bazë të kuqe ndrsa në mes është amblema e SASHK-ut.

Neni 86

SASHK-ut ka himnin e vet „Gjithmonë SASHK,“ me melodi dhe tekst që simbolizon SASHK-un.

Himni i SASHK-ut shfrytëzohet për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të SASHK-ut, duke filluar nga organizatat sindikale, këshillat regjional, deri te organet e SASHK-ut.

Himni "Gjithmone SASHK", detyrimisht luhet direkt (live) ose me intonim te regjistrimit; gjatë mbajtjes së Kongresit të rregullt ose te jashtëzakonshem te Sashk-ut, si dhe ne aktivitetet e SASHK-ut në të cilën marin pjesë edhe mysafir nga Organizatat sindikale ose federata nga jashtë vendit, të cilët mbahen në Republikën e Maqedonisë.

Neni 87

Në SASHK të drejtë vule kanë Këshilli, Këshillat regjionale dhe Organizatat sindikaliste.

Vula e Këshillit të SASHK-ut është e rrumbullakët dhe përmban këte tekst: SINDIKATA E PAVARUR PËR ARSIM, SHKENCË DHE KULTURË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË- SHKUP.

Vula e Këshillit regjional të SASHK-ut është e rrumbullakët dhe e përmban këtë emër: SINDIKATA E PAVARUR PËR ARSIM, SHKENCË DHE KULTURË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË - Këshilli regjional i SASHK-ut _____ emri i Regjionit dhe selia.

Vula e Organizatës sindikale është e rrumbullakët dhe përmban këtë emër: SINDIKATA E PAVARUR PËR ARSIM, SHKENCË DHE KULTURË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË- Organizata sindikaliste në _____.

Në mesin e vulës së Këshillit, të Këshillave regjionale dhe të vulës së Organizatave sindikaliste është amblema e SASHK-ut.

Neni 88

Për DITË TË SASHK-ut shpallet 14 korrik. Shënimi bëhet sipas Programit të cilin e sjell Këshilli i përgjithshëm i SASHK-ut.

14. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 89

Statutin e aprovon Kongresi i SASHK-ut.

Ndryshime dhe plotësime të Statutit në mes të dy Kongreseve bën Këshilli i SASHK-ut me dy të tretat e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Interpretimin e dispozitave të këtij Statuti e bën Këshilli.

Neni 90

Vendim për bashkim dhe shpërbërje në asociacione sindikale në vend dhe jashtë sjell Këshilli i përgjithshëm i SASHK-ut.

Neni 91

SASHK-u mund të përfundojë së ekzistuari në pajtim me raste të përcaktuara me Ligj.

Neni 92

Në organizatat sindikale në njësitë e vetqeverisjes lokale në të cilat përvec përdorimit të gjuhës maqedone dhe shkrimit të saj, në përdorim zyrtar është edhe gjuha dhe shkrimi tjetër i qytetarëve, Këshilli i SASHK-ut siguron komunikim me shkrim me Organizatat sindikale edhe ne ate alfabet.

Neni 93

Ky Statut hyn ne fuqi ditën e aprovimit.

Neni 94

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti përfundon të vlejë Statuti i SASHK-ut i datës 28.09.2014.

**Kryetari,
JAKIM NEDELKOV**

